




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
 AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT  
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. Dep. 2-D / DPK Nr. Prot. Br. Prot. 01-1372/2012  
 Nr. i faq. Prot. No. 01-1372/2012  
 Broj stranica Data 17-04-2012  
 Nr. pages 02 Datum 17-04-2012  
 PRISHTINE



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë **30.03.2012**, nxjerr këtë:

### V E N D I M

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-4785/11, për z. Genc PRELVUKAJ – Këshilltar Politik, për shkak se është shmangur situata me konflikt interesi në të cilën ndodhej ky Zyrtar i lartë publik.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

### A r s y e t i m

**I. Lidhur me rastin nr. AKK-03-4785/11 të hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, për Zyrtarin e lartë, Genc Prelvukaj – Këshilltar Politik i Ministrisë në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në Qeverinë e Kosovës, janë ndërmarrë veprimet sipas procedurës së paraparë ligjore, të nevojshme për këtë situatë (Ligji Nr.04/L-051, Neni 18, pika 1).**

Rasti është identifikuar me dyshimin e bazuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, që shfaqej nga ushtrimi i dy funksioneve të papajtueshme.

Një, si Këshilltar Politik i Ministrisë në MKRS, në njëren anë, dhe dy; ushtrimi i funksionit drejtues të biznesit privat, N.Sh."Eton", në anën tjetër. Për këtë Zyrtarit të lartë i është bërë shkresa e parë njoftuese nga Agjencia Kundër Korrupsionit – AKK, me datën 28.02.2012 (Neni 18, paragrafi 5, Ligjit Nr.04/L-051).

Kësaj shkrese Zyrtari i lartë, i është përgjigjur brenda afatit ligjor dhe në takim me zyrtarët e Agjencisë, ai është njoftuar për veprimet të cilat, ai në cilësinë e personit Zyrtar i lartë duhet t'i ndërmerr, për të shmangur situatën e papajtueshme gjatë ushtrimit të funksionit publik dhe funksionit drejtues në ndërmarrjen private.

Zyrtari i lartë, Genc Prelvukaj, me datën 28.03.2012 në Agjencinë Kundër Korrupsionit ka sjell Informatat mbi biznesin, ("Etnon" N.Sh.) të ndryshuara, në të cilat shihet se zyrtari Prelvukaj nuk ushtron më funksion menaxhuese e as drejtues në ndërmarrjen e përmendur. Këto të drejta tani, sipas ligjit, janë bartur te personi i tij i besuar.

Kështu, me këto informacione zyrtare mbi biznesin, të lëshuara nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, që janë sjellë në Agjencinë kundër Korrupsionit nga vet Zyrtari i lartë dhe kanë numër protokoli DPK/DPKI, 03-1194/2012, kemi konstatuar se është shmangur situata konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, gjithnjë duke u bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Nr.04/L-051).

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

